



## REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMËS

MUNICIPALITY OF SHTIME / OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESELDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM / INFORMATION OFFICE / KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga mbledhja e jashzakonshme e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), e mbajtur më 24 janar 2025, në ora 13:00, në sallën e vogël të Komunës së Shtimes

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Nënkyetari i Komunës, Faruk Beqa, komandanti i Stacionit Policor në Shtime, Haxhi Behluli, Lulzim Sahiti (DKA), Skender Dauti (ZMSH), Vlora Hyseni (ZI), Reshat Gashi (ZKD.ZBGJ), Yllka Fejzullahu (Drejtoria e Arsimit), Muhamet Mehmeti (ZKKK), Muhadin Halili (EVSB), Adem Ramadani (QPS), Enver Dugolli (U.d Drejtore “Emin Duraku”), Muharrem Haziri (OSCE), Mimoza Salihu-Qeriqi (DSHMS).

Nënkyetari i Komunës z. Beqa merr fjalën dhe falënderon të pranishmit që janë prezent në këtë mbledhje dhe prezanton pikën e vetme të rendit të ditës. Gjithashtu në mënyrë kronologjike njoftoi të pranishmit për ftesën e kësaj mbledhje.

### 1. Shqyrtimi i situatës së krijuar pas dhunës së shkaktuar nga S.S.

**Faruk Beqa:** Kemi parë të gjitha masat që kanë ndërmarrë institucionet në lidhje me rastin në fjalë. Jemi interesuar edhe se çfarë masa duhet të mirren për këtë nxënës, për shkak të moshës që ka. Janë shfrytëzuar të gjitha mekanizmat, si nga DKA, QPS, Policia.

Për këtë nxënësin, Sylejman Selimi janë marrë edhe gjykata dhe prokuroi, por prap e kanë sjellur dhe kanë thënë që ky duhet të shkon në shkollë, por kur ka ardhur në shkollë, ky ka shkaktuar incidente tjera, ku shkolla prap ka marrë masa duke e dërguar edhe në shkollë tjetër por prap pa kurfar përmirësim. Nga ajo që kemi parë deri më tanë, veprimet që ai i bënë, janë sikur vepra kriminale, ndërsa ligji e trajton sikur të mitur.

Kemi vizituar së bashku me kryetarin dhe Muhametin, djali i cili ishe dhunuar në një farë forme nga Sylejmani.

Për më shumë edhe komandanti mundet me na informu.

**Haxhi Behluli:** Ju pëershëndes të gjithëve. Duke ju referuar rastit në fjalë duhet të kërkojmë zgjidhje të mëtutjeshme. Për çështjen e Sylejmanit është një ndjenjë aspak e mirë, kur shikohet ajo video dhe veprimet që ka bërë, jo vetëm për neve si institucion por edhe për qytetarët.

Qytetarët presin nga ne si institucion se çka kemi bërë deri më tanë për trajtimin e këtij nxënësi. Sa për njoftim, gjatë vitit 2024 së bashku me QPS-në, 6 janë shënime zyrtare dhe 2 janë tash pranë 2025, me këtë të fundit që ndodhi. Kemi patur informata të ndryshme, për të cilat kemi kërkuar zgjidhje vazhdimisht. Kemi raporte në polici, që realisht kanë qenë të ftuar edhe prindërit, duke kërkuar zgjidhje, por të cilët nuk e kishin gatishmërinë dhe për këtë vazhdimisht kemi bashkëpunuar edhe QPS, që të hapim rast, mos kujdesje ndaj fëmijës. Por fakti që është nën moshë, po përcillet në forma të ligjshme. Po mundohemi dhe do të mundohemi që për këtë rast dhe raste të tjera të gjejmë zgjidhje vazhdimisht.

**Adem Ramadani:** Pëershëndetje për të gjithë, siç e dini edhe ju, është një periudhë e shkurtë që jam drejtor në QPS, por që jamë informuar se QPS-ja me rastin në fjalë është marrë që nga 30.05.2024, sidomos me Sylejman Seliminkemi. Pas publikimit të videos, kur ne jemi njoftuar me 16.1.2025 edhe pse video është bërë më herët por ne jemi njoftuar me 16 janar. Pas këtij rasti, ne fillimisht kemi vizituar familjen e Sylejman Selimit se si ka ndodhur rasti, në familjen e Albertit menjëherë nuk kemi shkuar për shkak të përbajtjes së videos, por më vonë i kemi vizituar edhe ata.

Problem në atë familje nuk është vetëm fëmija Sylejmani, por edhe familja. Nana e tij në njëfar mënyre është nxitëse, e cila në vazhdimësi e mbrojn fëmiun. Kemi marr vendim të përbashkët, që nënën dhe djalin të dërgohen në psikiatri, por nuk kanë pranuar duke na thënë që nuk jemi të sëmurë. Zyrtarët tanë kanë lajmëruar psikiatrinë dhe kanë biseduar me ta për rastin. Më pas janë dërguar edhe pse prindi si e ka parë që është spitali i psikiatrisë ka rezistuar, por më vonë është binduar. Të pranishëm kanë qenë dy psikiatra dhe një psikolog.

Sipas priklatrisë është rekomanduar që fëmija të shkon në një institucion për rehabilitim dhe u kanë shkruar edhe barna nanës dhe fëmijës, por nuk kanë pranuar. Sipas rekomandimit të tyre,

fëmija duhet të dërgohet në një rehabilitim të tipit të mbyllur për personan nën moshën 14 vjeç, por fatkeqështë një qendër e tillë nuk egziston në Kosovë. Jemi interesuar mos rastësisht ka në Shqipëri, por as atje nuk ka.

Sa i takon rastit të fëmijës së dytë, pra Albertit, kemi biseduar me familjen e tij dhe i kemi ftuar në seance psikologjike në QPS, kanë pranuar edhe familja dhe seancat po vazhdojnë.

Tani jemi në një situartë, kur të gjithë së bashku këtu të marrim një vendim për rastin e këtij rasti. Sipas meje, duhet t'a detyrojmë prindin që fëmiun t'a dërgojnë në shkollë por edhe ta marr nga shkolla. Shkolla në fjalë, mos ta pranon, as mos ta lëshon pa prezencën e prinditit.

Po të bisedoni më fëmiun (Sylejmanin), duket shumë fëmij i qetë dhe ta mbush mendjen si shumë i urtë, thot i kam ra pishman, nuk bëjë më, por gabimet i ka të përsëritura vazhdimisht.

Tani dua edhe mendimin e juaj, e sidomos të zyrtarëve nga arsimi, që këta fëmijë që aktualisht e vijojnë mësimin në shkolla të ndryshme, jo në shkollën ku kanë qenë, ti sjellim prap në shkollën e tyre, por nën masa të sigurisë nga prindërit.

**Muhamed Mehmeti:** Është një rast shumë i rëndë. Të komuniteti e kanë përjetuar shumë rëndë, sa që kanë tentuar edhe fëmijët ti ndalin nga shkolla. Si zyre, menjëherë këmi njofuar policinë, QPS-në dhe të gjitha institucionet, të cilat i falenderoj. Nëse veqse fëmijët kthehen në shkollë, mos të qëndrojnë më në klasë të njejtë, kjo është edhe kërkesë e prindërvë të Albertit. Gjithashtu kërkoj që policia ta shton prezencën në shkollë, por edhe të familja e Albertit, pasiqë jo më larg se dje, prindi i Sylejmanit ka shkuar të familja e Albertit që t'i kërkon falje, por aty ka eskaluar situata, prandaj kërkoj nga policia që këtyre ditëve sa është situata ende në tension të jetë pak më shumë prezente.

**Faruk Beqa:** Kemi parë që fëmiu, Sylejmani, nuk e zgjedh në baza nationale, nuk i intereson bash hiq, ky ka shumë vepra që ka shkaktuar edhe te nxënësit e tjerë, e të sheshi i qytetit.

**Enver Dugolli:** Sylejam Selimi, është nxënës i shkollës sonë, sa u përket vendimeve që janë marrë ndaj tij, realisht ai ka qenë i suspenduar nga shkolla para se të publikohet videoja, ka qenë i suspenduar jo për këtë ngjarje, por për raste tjera që ka shkelur rrregulloren e shkollës. Sipas informatave që kam marr në shkollë, gjatë kohës nuk nuk isha unë drejtor, atij i është ndërruar paralelja 5 herë, por është por që nuk ka patur efekt. Kemi pasur ankesa edhe nga prindërit. Dua

të them edhe këtë, edhe Alberti edhe Sylejmani janë shokë të ngushtë, veprimet i kanë të përbashkëta. Në publikimin e kësaj video, po e shohim që Alberti është viktima, por realisht në bazë të veprave që më herët ka bërë Alberti, është po i nejti me Sylejman Selimin. Edhe Alberti ka patur vendime të suspendimit që ka thyer rregulloren e shkollë.

Realisht, prej 9 dhjetorit që kam marrur këtë post, Alberti së bashku me Sylejmanin, nuk ka kaluar ditë pa e thyer rregulloren e shkollës dhe për këtë arsyen janë marrur vendimet.

Për këta dy nxënës, me sa kam parë unë, janë hargjuar kompetencat e shkollës. Duhet të mendojmë edhe për kthimin e tyre në shkollë, sepse me kthumin e tyre thyhet rregullorja e shkollës sepse ata veq se janë të suspenduar që të dy.

Kemi një informatë e këtë këtë dua t'ju njoftoj edhe juve, kemi një kërkesë nga prindërit e shkollës së Davidovcit, të cilët na kanë njoftuar se nëse Sylejman Selimi vazhdon mësimin në atë shkollë, do t'i ndalin fëmijët e tyre nga shkolla.

**Yllka Fejzullahu:** Ju falemnderit për këtë mbledhje kaq të rëndësishme, por mendoj që këtu mungojnë dy profesionist të cilët kishin mundur të na jepin shumë informata, si një njohës i mirë i anës ligjore, një prokuror i departamentit për të mitur ose ndnjë gjyqtar apo ndonjë avokat që e njeh mire anën ligjore se si duhet të veprohet në raste të tillë, për personat që nuk kanë përgjegjësi penale. Ne mbledhjet që kishim me kryetarin për këtë çështje, kemi ftuar edhe prokurorin nga departamenti për të mitur, por nuk ishin prezant, e as nuk e kanë sjellur dikënd për t'i përfaqësuar. Po të ishte një i tillë mendoj që në këtë rast do të na ndihmonte shumë. Prej që e kam marr mandatin si drejtoreshë, nuk nuk ka javë që nuk jemi marr me Sylejman Selimin, ka shkaktuar probleme, ka patur ankesa vazhdimisht, por pa patur një zgjidhje konkrete për të. Një ndër veprimet konkrete që une e mendoj është edhe identifikimi i personit që e ka bërë inqizimin e ngjarjes, që mandej të mirret policia me të, që përmes kësaj të ipet një mesazh te grapi që policia po mirret edhe me këto raste, që mos të veprohet më nga personat e tjera. Sipas informatave që kam, egziston edhe një pjesë te psikiatria që mirret me fëmijë, por më duhet ta verifikoj këtë.

Vetëm dua të shtoj edhe diçka, që faji mos të hidhet as te policia, as te shkolla, e as te drejtori, këtu nuk kemi dështuar ne si institucion, por këtu ka dështuar prindërimi.

**Muharrem Haziri:** Në bazë të vëzhgimit si OSCE të këtij rasti, kemi biseduar edhe me QPS, edhe me Muhametin, vërtet është një rast shqetësues, por në anën tjetër atë që kemi parë ne si OSBE, është një hapësirë ligjore që asnjerës prej institucioneve që i përmendën nuk i hidhet faji.

Mendoj që si OSBE të inicojmë së bashku organizimin e një tryeze të rrumbullakët nga e cila do të merrnim udhëzime se si ti çasemi kësaj pune.

**Faruk Beqa:** Duhet të dalim me konkluzione sa i takon kësaj mbledhje.

**Lulzim Sahiti:** Për këtë rast, kemi mbajtu edhe mbledhje të tjera dhe ende asgjë nuk kemi ndërmarrë, ndërsa i gjithë presioni bie mbi shkollat.

Duhet të marrim një qëndrim si KKSBB, që të dy fëmijët të kthehen në shkollë, me rekomandim të KKSBB-së.

Ne i kthejmë fëmijët, por me një kusht, që prindi i Albertit dhe prindi i Sylejmanit, sipas rekomandimit të KKSBB-së, të obligohen, që t'i dërgojnë fëmijët në shkollë dhe t'i marrin fëmijët nga shkolla.

Shkolla ka roje të dera, në rast se prindi nuk e sjellë, të lajmërohet policia dhe fëmija të ndalet nga roja, derisa të vjen policia.

Sylejmani të vijon mësimin në klasën ku edhe më parë ka vijuar, ndërsa Alberi të dërgohet në një klasë tjeter.

**Adem Ramadani:** Edhe une ju mbështes, që fëmijët të kthehen në shkollë, por që vazhdimisht të jenë nën kontrollë.

**Faruk Beqa:** Me kaq pra e përfundojmë këtë mbledhje, duke pas për bazë tanimë konkluzionin e marrë për këtë rast, i cili do të përgatitet dhe do t'u dërgohet zyrtarisht përmes e-mailave.

**Mbledhja përfundoi në ora : 14:20**













Procesmbajtëse:

Vlora Hyseni



**LISTA E PJESËMARRËSVE PËR MBLEDHJEN E JASHTZAKONSHME TË  
KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

Shtime 24 janar 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënskrimi
1	MUHAMADI HALILI	EVSB	
2	Rexhep Gashi	ZKD - ZKG	
3	ADM RAMADANI	Q.P.S	
4	FARUK BEQI	KOMUNA SHTIME	
5	Haxhi Bektuli	Policia Shtime Koaj. soxhoreti	
6	Emver Dugolli	U.d. Drejtori "Emin Iliraku"	
7	Muhamed Mehmeti	Zyrtar ZKK	
8	Muharrem Haziri	OSCB	
9	Shënolli Xanto	ZMSH	
10	Lulzim Saliu	DKA	
11	Yllka Fejzellahci	DRA	
12	Mimoza Zalbu Berzqi	DSHRS	
13	Vlora Tepeni	KOMUNA SHTIME	
14			
15			
16			
17			